




Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



QKSHF-ja do të ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror dhe mbështetjes drejt punësimit për të gjithë të rinjtë, gratë dhe familjet e tyre që banojnë në qytetin e Ballshit dhe fshatrat përreth dhe gjenden në vështirësi socio-ekonomike.

QENDRA KOMUNITARE SHUMËFUNKSIONALE BALLSH

SHËRBIME PËR TË RINJTË, GRATË DHE
FAMILJET NË SITUATË TË VËSHTIRË.

SHËRBIME LËVIZËSE NË KOMUNITET

**NËSE TI NUK MUND TË VISH TEK NE,
VIJMË NE TEK TI!**

shërbim do të ofrojë menaxhim rasti he mbështetje psiko-shoqërore në munitet për të gjithë ata individë dhe milje të cilët e kanë të pamundur të arrin shërbime direkte në qendër.

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Modeli i Qëndrueshëm për Shërbimet e Integruara të Punësimit dhe Kujdesit Social në Bashkinë Mallakastër” bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, koordinuar nga Bashkia Mallakastër në partneritet me Help in Albania dhe Qendrën Sociale Murialdo Fier.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Lagja 5 Shkurti, Rr. Zenel Hekali,
Ndërtesa nr. 51 Hyrja 1
Kod postar 9308



Shërbimet që do të ofrohen në qendër:

MENAXHIM RASTI DHE SHËRBIME TË REFERIMIT.

Duke siguruar hap pas hapi ofrimin e vazhdueshëm e efektiv të ndihmës për individët në situatë të vështirë (fëmijë, të rritur apo familje) dhe synuar promovimin, mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e personit.

Nëpërmjet menaxhimit do të adresohen nevojat materiale, të strehimit, ligjore, psikologjike, shoqërore, mendore, shëndetësore, të punësimit të individëve/familjarëve dhe statusin e tyre në sistemin shoqëror/komunitar.



• SHËRBIME MBËSHTETËSE TË FAMILJES

TË JESH PRIND SOT ËSHTË SFIDË E VËSHTIRË DHE MJAFT KOMPLEKSE.

Fokusi i grupeve mbështetëse për prindërit është krijimi i marrëdhënieve të shëndetshme dhe pozitive mes prindërve dhe fëmijëve në mjedisin familjar.

SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË TË RINJVE

Aftësi për jetën dhe edukim qytetar ku të rinjtë do të angazhohen në takime të vazhdueshme më qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, përforcimin e aftësive jetësore, përmirësimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe prindërit si dhe zhvillimin e aftësive mendore, fizike dhe emocionale.



Aktivitete psiko-shoqërore me në fokus mirëqenien psiko-shoqërore e të rinjve - zhvillimi i aftësive të tyre jetike (përshtatshmërisë, bashkëpunimit, empatisë, menaxhimit të emocioneve, komunikimit dhe marrjes së përgjegjësisë).

Ndihmë psikologjike për të rinjtë.